



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr.104/02- 4308/22
Kaçanik: 28.02.2022

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28 shkurt 2022, pos tjerash, u;

INFORMUA

1. Për punën e Zyrës së Personelit të Komunës së Kaçanikut për periudhën Janar - Dhjetor 2021, me tekstin e mëtejme "Informatë e menaxhimit të burimeve njerzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021"
2. Në materialin si në pikën 1 të kësaj shkrese, është paraqitur aktiviteti i Zyrës së Personelit për periudhën Janar – Dhjetor 2021, në të cilën janë pëfshirë të gjitha procedurat të cilat kryhen nga zyra e personelit, si dhe aktivitete tjera që janë në kuadër të kësaj zyre.
3. Me këtë Shkresë njoftohet: Kryetari i Komunës, Zyra e Personelit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

DATË/A:	14.02.2022
REFERENC-Ë:	01-105/02-4308/22
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës Kaçanik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hidajete Guri- Udhëheqëse e personelit - <i>Hidajete Guri</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën janar- dhjetor 2021

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore në Komunën e Kaçanikut funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe në përbërje të saj ka tre zyrtar : Udhëheqësin/Menaxherin e personelit dhe dy zyrtar të personelit, të cilët zhvillojnë të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me fushën e burimeve njerëzore të të gjithë të punësuarve në kuadër të Komunës, sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për zyrtarët publik .

Në fillim të vitit 2021, në kuadër të objektivave të përcaktuara për këtë vit janë caktuar edhe aktivitetet konkrete me të cilat do të merremi përkatësisht, është përgatitur plani i punës për vitin e ri kalendarik.

Sipas rregullores së vlerësimeve vjetore të nëpunësve civil përkatësisht, pas përmbylljes së procesit të vlerësimit vjetor të nëpunësve civil nga Ekzekutivi i Komunës, është hartuar raporti përmbledhës i vlerësimeve vjetore të nëpunësve civil për vitin 2020 dhe plani i trajnimeve për vitin 2021, të cilat janë përcjellë në DMZP-MPB. Gjithashtu, zyra e personelit njofton nëpunësit civil me trajnimet që ofrohen nga Instituti i Kosovës për Administratë publike.

Sipas Legjislacionit në fuqi dhe Planit të personelit për vitin 2021 nga zyra e personelit janë zhvilluar këto procedura të rekrutimit të cilat janë publikuar përmes portalit për rekrutim elektronik <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe web-faqes së Komunës:

Administrata komunale

Nëpunës të shërbimit civil:

- Dymbëdhjetë (12) procedura të Lëvizjes brenda kategorisë – përmes së cilave kemi plotësuar tri pozita, për një të tretën prej këtyre pozitave procesi i emërimit është kryer në këtë vit.
- Tre (3) procedura të pranimit- prej të cilave kemi plotësuar dy pozita ndërsa, një procedurë ka qenë në proces këtë vit dhe tani e kemi përfunduar procedurën

E tërë procedura për nëpunësit e shërbimit civil zhvillohet përmes sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ –së).

Nëpunës administrativ teknik dhe mbështetës:

- Tre (3) Konkurse për 7 pozita të lira

Arsim

- Kemi shpallur konkurse për 51 pozita të lira dhe janë plotësuar 33 pozita. Ndërsa, konkursi i fundit është në proces të zhvillimit të procedurave.

Shëndetësi

-Kemi shpallur konkurse për plotësimin e pesëmbëdhjetë (15) pozitive të lira. Prej tyre tre pozita të kategorisë së Nëpunësve administrativ teknik dhe mbështetës.

Sa i përket procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, kemi pasur dy ankesa kundër procesit të verifikimit paraprak të dokumenteve për të cilat kemi marrë vendim për refuzimin e ankesës. Ndërsa, në Këshillin e pavarur mbikëqyrës të Kosovës (KPMSHCK) janë paraqitur dy (2) ankesa kundër procedurave në shërbimin civil dhe një (1) ankesë kundër procedurave të rekrutimit në shërbimin publik (arsim).

Për KPMSHCK-brenda afatit të paraparë ligjor kemi përgatitur përgjigjen me shkrim në ankesa dhe kemi bërë kompletimin e dosjes për rastet konkrete, përkatësisht e tërë procedura e kontestuar është dorëzuar në KPMSHCK- për shqyrtim.

Gjithashtu me kërkesë të Gjykatës themelore në Ferizaj- dega në Kaçanik jemi përgjigjur me shkrim lidhur me një padi të parashtruar në këtë Gjykatë.

Në komisionin komunal për ankesa për procedurat e rekrutimit në sektorin e arsimit janë shqyrtuar njëmbëdhjetë(11) ankesa.

Qasje në dokumente publike kemi pasur dy kërkesa të cilave ju kemi përgjigjur brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Gjatë vitit 2021 në komision disiplinor janë shqyrtuar dy procedura të Nëpunësve teknik dhe mbështetës. Prej tyre njëri rast ka qenë në administratën komunale dhe tjetri në sektorin e arsimit për të cilët janë shqyrtuar masa disiplinore.

Në shërbimin civil komunal kemi pasur shtatë (7) ndërprerje/përfundime/pezullime të marrëdhënies së punës:

- Katër (4) përfundime të marrëdhënies së punës së nëpunësve civil me rastin e pensionimit.
- Një (1) përfundime të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil me rastin e vdekjes
- Një (1) ndërprerje të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil sipas kërkesës së tij.
- Një (1) pezullim të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil sipas kërkesës së tij.

Në sektorin e arsimit kemi pasur njëzet e gjashtë (26) ndërprerje/përfundime të marrëdhënies së punës:

- Nëntëmbëdhjetë (19) përfundime të marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit
- Tre (3) ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të skadimit të kontratës
- Katër (4) ndërprerje të marrëdhënies së punës me kërkesë të punësuarit

Në sektorin e shëndetësisë kemi pasur trembëdhjetë (13) ndërprerje/përfundime të marrëdhënies së punës:

- Tre (3) përfundime të marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit
- Dhjetë (10) ndërprerje të marrëdhënies së punës sipas kërkesave të tyre

Të gjithë nëpunësve civil me rastin e pensionimit sipas Ligjit për pagat dhe Rregullores për kompensimin e nëpunësve civil iu është lejuar një pagë përcjellëse pas pensionimit. Po ashtu, një pagë iu është ndarë edhe familjes së nëpunësit civil të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të vdekjes.

Duke u bazuar në Rregulloren e cekur më lartë janë nxjerrë edhe pesëmbëdhjetë (15) vendime për shpërblimin jubile, nëpunësve civil (në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil) dhe një (1) vendim për shkak të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, iu është lejuar ndarja e një page mesatare mujore në shërbimin civil dhe dy 2 vendime për nëpunësit civil për punën jashtë orarit të rregullt të punës. Vendime për lejimin e udhëtimit zyrtar jashtë shtetit janë dy (2).

Gjatë vitit 2021 – janë nxjerrë edhe shtatë (7) vendime për transferim të Inspektorëve nga Drejtoritë në Njësinë/Zyrën e inspektoratit.

Procedura e pushimeve zhvillohet në vazhdimësi gjatë tërë vitit. Përveç pushimeve vjetore, kemi të evidentuara:

- Tri (3) vendime të pushimit të lehonisë në shërbimin civil komunal dhe dy (2) vendime për pushim pa pagesë, bëhet ruajtja e tyre në mënyrë elektronike dhe në dosje personale për tërë personelin e Komunës.

- Në arsim kemi të evidentuara tetëmbëdhjet (18) pushime të lehonisë dhe katër pushime pa pagesë.

- Në shëndetësi kemi të evidentuara tre (3) pushime të lehonisë.

Sipas Rregullores për procedurën e planifikimit të personelit, është hartuar plani i personelit për vitin 2022 në formë fizike dhe përmes SIMBNJ-së. Ky draft është përcjellë në DMZP/MPB për miratim.

Udhëheqësi i personelit duke u bazuar në Legjislacionin në fuqi, brenda afateve të përcaktuara me Ligj dhe Rregulloret përkatëse, ka njoftuar ekzekutivin e komunës për veprimet që duhet t'i ndërmarrin për zbatimin e Ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të nxjerra sipas tyre.

Në zyrën e personelit në vazhdimësi bëhet kompletimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit në mënyrë fizike dhe elektronike (SIMBNJ) dhe rifreskimi i tyre.

Për Departamentin për menaxhimin e zyrtarëve publik kemi plotësuar raporte statistikore me të dhënat e kërkuara për të gjitha procedurat e zhvilluara të personelit dhe me të dhënat e të punësuarve, numrin, strukturën gjinore, etnike dhe kualifikuese, personat me aftësi të kufizuara etj. Duke u bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publik dhe në rregulloren nr.10/2020 për deklarimin e statusit të zyrtarëve publik kemi nxjerrë vendime sa i përket statusit të zyrtarëve publik.

Po ashtu, zyra e personelit sa i përket çështjeve të personelit raporton edhe në MAPL- lidhur me obligimet e komunave nga agjenda evropiane.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në tërë organizatën buxhetore (administratë, arsim, shëndetësi, Kuvendi komunal dhe zjarrfikës) në fund të vitit 2021, sipas raportit financiar të muajit dhjetor arrin Shtatëqind e nëntëdhjetë e tre (793) të punësuar, prej tyre :

- Në administratën komunale numri i përgjithshëm i të punësuarve ka arritur Njëqind e njëzet (120) të punësuar, duke mos llogaritur edhe shërbimin e zjarrfikësve i cili numëron 18 të punësuar të cilët janë të transferuar në nivelin qendror por paguhen nga buxheti i komunës.

- Në arsim numri i përgjithshëm i të punësuarve në fund të vitit ka qenë pesëqind e tridhjetë (530)

- Në shëndetësi numri i përgjithshëm i të punësuarve në fund të vitit ka qenë 98 zyrtar publik.

Zyra e personelit përgatit formularët për sistemin e pagave dhe ka qasjen edhe në sistemin e pagave, ku përmes këtij sistemi bënë nxjerrjen e listave të pagave dhe raportin financiar. Pas shqyrtimit të tyre sigurohemi që ndryshimet e dërguara janë proceduar në sistem. Të njëjtat dërgohen te Drejtorit përkatëse dhe zyrtarët për nënshkrim. Kemi përcjellë sistemin e hyrje-daljeve të punëtorëve, vonesat dhe mungesat e tyre, duke kërkuar që të zbatohet orari i punës.

Me kërkesë të Zyrtarëve publik të komunës janë lëshuar vërtetime mbi përvojën e punës.

Udhëheqësi i personelit me vendim të MPB-së është caktuar anëtar i komisionit/ekipit punues për hartimin e draftit fillestar të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për zyrtarët publik dhe në vazhdimësi ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Udhëheqësi i personelit në vazhdimësi e njofton Kryetarin e Komunës lidhur me zhvillimin e të gjitha procedurave të burimeve njerëzore.